VENDIM
Nr. 147, datë 13.3.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI "NDËRTIMI I LINJËS 110 kV UNAZA E TIRANËS"

(Ndryshuar me VKM nr. 363[1], datë 20.5.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i linjës 110 kV Unaza e Tiranës".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).
3. *Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë" dhe "ullishte", me vlerë të përgjithshme prej 818 315.92 (tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e dy) lekësh.*
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej *818 315.92 (tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e dy) lekësh,* përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në "Fletoren zyrtare" dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).
8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST).
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë, në favor të shtetit dhe në përgjegjësi administrimi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

---

[1] *VKM nr. 363, datë 20.5.2026 në pikën 2 shprehet;*

'' 2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.''

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit dhe në përgjegjësi administrimi të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., (OST) për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST), Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I LINJËS 110 kV UNAZA E TIRANËS"

(Ndryshuar me VKM nr. 363, datë 20.5.2026)

Nr. rendor	NR. Shtylle	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				Shënime
										Arë			VLERA TOTALE (lekë)	
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)		
1	1	Zurije	Ferit	Gjashta	Petrelë	2947	371/11	Are	8,000	162.05	1,406	227,842	227,842	
		Lorenc	Myrteza	Gjashta										
		Klodian	Myrteza	Gjashta										
2	1	Zurije	Ferit	Gjashta	Petrelë	2947	371/11	Are	8,000	139.90	1,406	196,699	196,699	
		Lorenc	Myrteza	Gjashta										
		Klodian	Myrteza	Gjashta										
3	8	Skender	Abdyl	Tujani	Mjull Bathore	2704	381/154	Ullishte	4,675	254.08	602	152,956	152,956	
4	9	AUTO ZIP			Mjull Bathore	2704	381/173	Ullishte	16,000	190.44	602	114,645	114,645	
5	10	CITYMEAD			Mjull Bathore	2704	509/7	Ullishte	3,500	94.67	602	56,991	56,991	
6	11	Suela	Zyhdi	Husha	Mjull Bathore	2704	508/2	Ullishte	4,000	114.92	602	69,182	69,182	
		Mimoza	Jahja	Husha										
VLERA TOTALE													**818,315.92**	